



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0109
Data e Vendimit: 25.02.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Bold Security” SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, U.D Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 25.02.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jo e plotë, ankesa e OE “Bold Security” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0109, e datës 10.02.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, i iniciuar nga Komuna Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 10.02.2025, ka pranuar ankesën e OE “Bold Security” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1 të AK- Komuna së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 25.09.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05 dhe me datën 29.01.2025 është publikuar formulari B54 për korrigjim të gabimeve ku Ofertat janë paraparë të dorëzohen jo më vonë se 11.02.2025 ora 14:00.

Me datën 05.02.2025, OE “Bold Security” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila me datën 07.02.2025 ka publikuar vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim të cilën e ka konsideruar si pjesërisht të bazuar.

Kundër vendimit të AK-së me datën 10.02.2025, OE “Bold Security” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0109 (Nr. protokolli)

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, është konstatuar se operatori ekonomik ankues nuk ka dorëzuar dëshmi bankare për pagesën (nuk ka kryer pagesë) siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për prokurim publik 001/2022 si dhe nenin 118 te LPP-se.

Nga OSHP, me datën 12.02.2025, përmes email-it zyrtar të OSHP-së është kërkuar nga OE “Bold Security” SH.P.K që brenda afatit ligjor të dorëzojë dëshmitë (verifikimin bankar) për kryerjen e pagesës, me paralajmërimin që nëse pagesa nuk kryhet ankesa do të refuzohet. Edhe përkundër email-it me njoftim të dërguar nga OSHP, OE ne fjale nuk i është përgjigjur kërkesës se OSHP-se për plotësim të ankesës- kryerjen e pagesës.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas te gjitha fakteve te analizuara sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenit 111 par 1.10 dhe nenit 118 par 1 dhe 2 te LPP-se si dhe nenit 69 par 2 te Rregullores për Prokurim Publik, andaj mbi bazën e këtyre dispozitave ankesa e OE “Bold Security” SH.P.K hedhet poshtë si jo e plotë (nuk shqyrtohet)

dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna së Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Bold Security SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: